



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prokuror - Prokuroria MRE/Dana			
30.03.2023			
Nr. i organit (Pro. broj)	Nr. i dërgimit	Shtetësi Prilog	Vlera Vredatimi
01-MO/05-277			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 17, paragrafi 1 shkronja o, neni 40 paragrafi 40.2 shkronja i, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.03.2023, merr këtë:

V E N D I M

për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve), në Komunën e Vitisë me fshatra

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, miraton vendimin për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve) në Komunën e Vitisë me fshatra.

Komisioni ka këtë përbërje:

- | | |
|---------------------|--|
| 1. Sokol Shaqiri | nga subjekti politik LDK, anëtar; |
| 2. Liridona Bislimi | nga subjekti politik VV, anëtar; |
| 3. Musli Neziri | nga subjekti politik PDK, anëtar; |
| 4. Feat Shaqiri | Gjeodet, anëtar; |
| 5. Hekuran Azemi | Historian, anëtar; |
| 6. Xhemajl Sadiku | Veteran i luftës, anëtar; |
| 7. Perparim Sadiku | Gjuhëtar, anëtar; |
| 8. Feride Latifi | Sociolog, anëtar; |
| 9. Qëndrim Kajolli | Koordinator i Këshillave të Fshatrave, anëtar; |
| 10. Florim Brahimi | shoqëria civile, anëtar; |
| 11. Sadat Sejdiu | Drejtorja e Urbanizmit. |

Neni 2

Anëtarët e Komisionit, nga neni 1 të këtij vendimi zgjedhen me mandat në kohëzgjatje si të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Neni 3

Komisioni në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin për emërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve) në Komunën e Vitisë me fshatra.

Neni 4

Detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë: shqyrtimi i kërkesave, ankesave, për emërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike në Komunën e Vitisë me fshatra, dhe përgatitja e propozimeve bazuar në kriteret përkatëse të përcaktuara me ligjet apo aktet nënligjore në fuqi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe anëtarët e këtij komisioni.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi me Nr.01-110/05-262, i datës 10.06.2019 mbi formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve) në Komunën e Vitisë me fshatra.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit;
2. Zyrës së Kryetarit.
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi